

Titulli i lëndës: **Gazetaria hulumtuese**

Informatat themelore për lëndën		
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë, Departamenti i Gazetarisë	
Titulli i lëndës:	Gazetaria hulumtuese	
Niveli:	Bachelor	
Statusi i lëndës:	Obligative	
Viti i studimeve:	III/ semestri VI	
Numri i orëve në javë:	2+2	
Kreditë ECTS:	6	
Koha / Vendi:	Sipas orarit	
Mësimdhënësi:	Prof. Ass. Dr. Alban Zeneli	
Të dhënat kontaktuese:	alban.zeneli@uni-pr.edu	
Përshkrimi i lëndës:	Gazetaria Hulumtuese është një fushë e specializuar e gazetarisë që merret me kërkimin e thelluar dhe analizën e çështjeve që mund të zbulojnë keqpërdorime, korrupsion apo shkelje të interesit publik. Kjo lëndë u ofron studentëve njohuri praktike dhe teorike për mënyrën se si të gjurmojnë dhe dokumentojnë parregullsitë, përmes punës me dokumente zyrtare, burime online, intervista dhe raportim në terren. Nëpërmjet kësaj lënde, studentët zhvillojnë aftësi për të menaxhuar sasi të mëdha të dhënash, për të analizuar informacione të ndërlikuara, si dhe për të kuptuar bazën ligjore që rregullon mediat dhe lirinë e informimit. Fokus i veçantë i jepet punës me dokumente, hulumtimin online dhe ndërtimit të rrëfimeve hulumtuese që mbështeten në prova të besueshme dhe burime të shumta. Në përfundim të kursit, studentët do të jenë të përgatitur të prodhojnë materiale të nivelit profesional, të denja për publikim në media investiguese.	
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i lëndës është të pajisë studentët me mjete bashkëkohore dhe teknika të avancuara të raportimit investigativ, duke i aftësuar ata të kuptojnë dhe të zbatojnë vlerat themelore të kësaj fushe. Lënda pasqyron përvojat profesionale të redaksive moderne dhe thekson rolin e gazetarit si mbikëqyrës i pushteteve, duke ofruar një qasje praktike dhe të përqendruar në etikën dhe përgjegjësinë publike. Gjatë studimeve, studentët do të mësojnë teknika të sofistikuar të hulumtimit dhe do t'i aplikojnë ato në projekte konkrete,	

	individualisht ose në grup. Procesi i të nxënit do të përfshijë mbledhjen dhe verifikimin e informacionit, analizën e burimeve dhe prodhimin e materialeve gazetareske që përmbajnë prova të qarta dhe narrativë të strukturuar. Kjo lëndë synon të zhvillojë aftësi kritike dhe praktike për krijimin e raportimeve hulumtuese me ndikim real në shoqëri.		
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Rezultatet e pritura të nxënies janë: Të shpjegojë parimet dhe vlerat themelore të gazetarisë hulumtuese, duke përfshirë rëndësinë e etikës dhe përgjegjësisë profesionale. Të zbatojë teknika të avancuara të kërkimit dhe hulumtimit, përfshirë analizën e dokumenteve, intervistat dhe punën në terren. Të përdorë metodologji efektive për mbledhjen dhe verifikimin e informacionit nga burime të ndryshme, duke siguruar saktësi dhe besueshmëri. Të menaxhojë dhe të analizojë sasi të mëdha të dhënash dhe dokumentesh në funksion të krijimit të tregimeve investiguese. Të punojë në mënyrë efektive si pjesë e një ekipi apo individualisht gjatë procesit të hulumtimit dhe raportimit. Të prodhojë materiale gazetareske të strukturuar dhe të bazuara në fakte, që adresojnë çështje me interes publik. Të përdorë mjete dhe teknika moderne të raportimit investigativ, duke reflektuar praktikën dhe sfidat e redaksive bashkëkohore.		
	Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)		
Aktiviteti	Orë	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	30
Teori/Punë në laborator/Ushtime	2	15	30
Punë praktike	/	/	/
Përgatitje për test intermediar	/	/	/
Konsultime me mësimdhënësin	10 min	15	2.5
Puna në terren	/	/	/
Testi, punimi i seminarit	12	1	12
Detyrë shtëpie	2	15	30

Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	2	15	30
Përgatitja për provimin final	10	1	10
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	3	2	6
Projektet, prezantimet, etj.	30 min	2	1
Total			151.5 orë= 6 ECTS

Metodat e mësimdhënies:	Metodologjia e mësimdhënies është e mbështetur para së gjithash në ligjërata në klasë dhe në ushtrime në klasë. Studentët që ndjekin këtë kurs kanë mundësi të ndjekin edhe ligjërata të gërshtuara me ushtrime, si dhe orë interaktive të diskutimeve për punimet e tyre të pavarura. Studentët marrin pikë vlerësuese që llogariten në ndërtimin e notës përfundimtare përmes detyrave në klasë dhe në shtëpi dhe përmes punës së pavarur në realizimin e shkrimeve. Këshillimet janë pjesë integrale e metodologjisë së mësimdhënies, sidomos në fazat kur studentët përgatisin punimet e tyre.	
Metodat e vlerësimit:	10%	Testi semestral
	20%	Ushtrimet
	10%	Ligjërata
	30%	Detyra semestrare
	30%	Provimi
Literatura primare:	“Story-Based Inquiry: a Manual for Investigative Journalists”, Mark Lee Hunter, UNESCO “Të gërmosh më thellë”, Shilla O’Conell, BIRN “ABC-ja e Gazetarisë” – KAS - Redaktuar nga Claudia Mast "Investigative Journalism: Proven Strategies for Reporting the Story", William Gaines “LegalLeaks: Toolkit: A guide for journalists on how to access government information	
	“Raportimi mbi Inteligjencën Artificiale – Doracak për Edukatorët e Gazetarisë” UNESCO / Këshilli për Etikë në Media në Maqedoni Etika Pres Skopje 2024	

Hartimi i planit mësimor	
Java	Titulli i ligjërates
Java 1:	Hyrje në gazetarinë hulumtuese: konceptet dhe rëndësia shoqërore
Java 2:	Etika dhe përgjegjësia profesionale në gazetarinë hulumtuese
Java 3:	Kuadri ligjor për median dhe lirinë e informacionit
Java 4:	Identifikimi dhe zgjedhja e temave për hulumtim gazetaresk
Java 5:	Metodat e kërkimit dhe mbledhjes së të dhënave në gazetari hulumtuese
Java 6:	Puna me dokumente: si të analizosh dhe interpretohesh dokumente zyrtare
Java 7:	Teknika e intervistimit dhe marrëdhëniet me burimet e informacionit
Java 8:	Test messemtral
Java 9:	Hulumtimi në terren: sfidat dhe metodat praktike
Java 10:	Menaxhimi i të dhënave dhe organizimi i informacionit gjatë hetimit
Java 11:	Përdorimi i teknologjive dhe mjeteve digjitale në gazetarinë hulumtuese
Java 12:	Analiza dhe verifikimi i burimeve dhe të dhënave
Java 13:	Ndërtimi i rrëfimit hulumtues dhe strukturimi i raportit për publikim
Java 14:	Raste studimore nga gazetaria hulumtuese ndërkombëtare dhe lokale
Java 15:	Sfida dhe kërcënime ndaj gazetarëve hulumtues: siguria dhe mbrojtja
Politikat akademike dhe kodi i sjelljes	
Studentët janë të obliguar të respektojnë normat themelore të sjelljes gjatë kohës së ligjëratave dhe ushtrimeve. Gjatë ushtrimeve studentët janë të obliguar të marrin pjesë aktive në mësim interaktiv. Atyre u mundësohet edhe prezantimi individual dhe grupor dhe qasja interaktive në mësim.	